



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

ANEKSI Nr. 1

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE ALBANIA SHA. dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifët përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Planet tarifore One Business+

One Business+	One Business+ Basic	One Business+ Light	One Business+ Essential	One Business+ Premium	One Business+ Professional	One Business+ Enterprise	One Business+ Exclusive
Pajtimi mujor (Lekë me TVSH)	1,225	1,530	1,940	2,450	3,065	5,620	12,260
Internet*	Pa limit deri në 600 Mbps	Pa limit deri në 600 Mbps	Pa limit deri në 600 Mbps	Pa limit deri në 2 Gbps	Pa limit deri në 2 Gbps	Pa limit deri në 2 Gbps	Pa limit deri në 2 Gbps
Minuta Kombëtare**	1,500	2,000	2,500	Pa limit	Pa limit	Pa limit	Pa limit
SMS Kombëtare***	1,500	2,000	2,500	Pa limit	Pa limit	Pa limit	Pa limit
Minuta Ndërkombëtare	10	50	100	100	150	250	600
SMS ndërkombëtare	10	50	100	100	150	250	600
Tarifë ditore Roaming (Leke/dite)	-	-	-	-	200	200	0

Shënime:

* Interneti në shpejtësi 3G/4G/5G është i vlefshëm sipas Politikës së Përdorimit të Drejtë si më poshtë:

- One Business+ Basic përmban 10GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 600 Mbps. Kur arrini volumnin 10 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Light përmban 30GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 600 Mbps. Kur arrini volumnin 30 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Essential përmban 50 GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 600 Mbps. Kur arrini volumnin 50 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Premium përmban 300 GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 2 Gbps. Kur arrini volumnin 300 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Professional përmban 500 GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 2 Gbps. Kur arrini volumnin 500 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Enterprise përmban 800 GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 2 Gbps. Kur arrini volumnin 800 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.
- One Business+ Exclusive përmban 2,000 GB - Internet me shpejtësi 4G/5G deri në 2 Gbps. Kur arrini volumnin 2000 GB, do të vazhdoni të lundroni me shpejtësi të reduktuar 256 kbps.

** Në minutat kombëtare pa limit do të aplikohet politika e përdorimit të drejtë, deri në 15,000 minuta

*** SMS kombëtare pa limit të planeve tarifore One Business+ Premium dhe One Business+ Professional do të aplikohet politika e përdorimit të drejtë, deri në 3000 SMS.

*** SMS kombëtare pa limit të planeve tarifore One Business+ Enterprise dhe One Business+ Exclusive do të aplikohet politika e përdorimit të drejtë, deri në 5000 SMS

- Të gjitha tarifët e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- Minutat ndërkombëtare janë të vlefshme drejt operatorëve në Rumani, Austri, Bullgari, Serbi, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Turqi, Mbretëri e Bashkuar, Belgjike, Kine, Maqedonia e Veriut, Gjermani, Greqi, Hollande, Norvegji, Poloni, Kroaci,



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Lagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

- Republika Çeke, Danimarkë, Francë, Hungari, Irlandë, Itali, Luksemburg, Mal i Zi, SHBA, Kanada, Kosovë, Australi, Qipro, Bosnje dhe Hercegovinë, Rusi, Ukrainë, Finlandë, Portugali, Sllovaki, Malte, Izrael, Afrika e Jugut, Korea e Jugut dhe Indi.
- Me kalimin e kufirit të përdorimit të drejtë për shërbimet zanore dhe SMS kombëtare të përcaktuara më lartë, pajtimtari do të tarifohet sipas listës së tarifave standarde.
 - Informacionin e përditësuar në lidhje me tarifën dhe zonat ndërkombëtare e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të internetit <https://www.one.al/>
 - Informacionin në lidhje me operatorët, zonat dhe tarifën për njësi për shërbimin Roaming do të mund të gjeni në faqen zyrtare të internetit <https://smartroam.one.al/>
 - Pajtimi mujor dhe njësitë e përfshira në paketë (minuta, SMS, MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit dhe çaktivizimit.
 - Koha fillestare e tarifimit është 60 sekonda, më pas do të aplikohet tarifimi për sekondë.
 - Përlllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
 - Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
 - Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
 - Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës.
 - Kufiri maksimal i kreditimit i shprehur në lekë, për përdorimin e shërbimeve prej Pajtimtarit sipas programit të zgjedhur, përcaktohet në formularin e pajtimit bashkëlidhur, pjesë e pandashme e kontratës së pajtimit. Shuma e përcaktuar si limit krediti do të aplikohet në përputhje me planin tarifor të zgjedhur prej pajtimtarit. Ky kredit limit do të përdoret për shërbime të cilat nuk janë të përfshira në programin tarifor të zgjedhur, duke i ofruar Pajtimtarit fleksibilitet në përdorim dhe njëkohësisht edhe mundësi për të kontrolluar shpenzimet. Pajtimtari mund të përditësojë në çdo moment limitin e kreditit. Ky përditësim mund të bëhet duke njoftuar përfaqësuesin e shitjeve.
 - ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke ju referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë të aplikojë këtë ndryshim jo më shumë se një herë në vit si dhe jo më vonë se 2 muaj pas publikimit të INSTAT.

Tarifat pas përfundimit të njësisë të përfshira në program:

Destinacioni	Tarifat (pas konsumit të njësisë falas)
Minuta Kombëtare	9.190 lekë/min
Tarifat ndërkombëtare	
Zona 1	61.300 lekë/min
Zona 2	113.430 lekë/min
Zona 3	128.760 lekë/min
Zona 4	233.000 lekë/min
Zona 5	367.900 lekë/min
Shërbime të tjera	
SMS Kombëtare	4.080 lekë/SMS
SMS Ndërkombëtare	9.190 lekë/SMS

Planet One Business+ janë të vlefshme edhe në Roaming në Ballkanin Perëndimor. Minutat dhe SMS kombëtare përdoren në Ballkanin Perëndimor të plota si në Shqipëri, nderkohe për internetin aplikohet Politika e Përdorimit të Drejtë (FUP) si me poshtë:

Planet tarifore	Interneti i vlefshëm në Ballkanin Perëndimor
One Business+ Basic	2.06 GB
One Business+ Light	2.58 GB



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

One Business+ Essential	3.26 GB
One Business+ Premium	4.12 GB
One Business+ Professional	5.15 GB
One Business+ Enterprise	9.45 GB
One Business+ Exclusive	20.62 GB

Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

	Zona Ballkani Perëndimor		Zona 1	Zona 2	Zona 3
	Kombëtare dhe Ballkani Perëndimor	Destinacione të tjera			
Minuta dalëse	30 lekë/min	100 lekë/min	100 lekë/min	500 lekë/min	750 lekë/min
Minuta hyrëse	Falas	100 lekë/min	100 lekë/min	100 lekë/min	100 lekë/min
SMS dalëse	10 lekë/SMS	10 lekë/SMS	10 lekë/SMS	10 lekë/SMS	10 lekë/SMS
SMS hyrëse	Falas		Falas	Falas	Falas
Internet	1.14 lekë/MB		2.4 lekë/MB	160 lekë/MB	1600 lekë/MB

SHËNIME PËR SHËRBIMIN ROAMING

- 1) Paketat, ofertat dhe koha e bisedës falas që pajtimtari ka përfutuar duke aktivizuar ndonjë nga paketat bazë apo ato opsionale, nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të konsumohen ndërkohë që klienti përdor shërbimin Roaming, përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë përdorimit të shërbimit Roaming do të aplikohen tarifat e përcaktuara dhe të sipërpërmendura në tabelën 'Tarifat standarde të shërbimit Roaming'.
- 2) Njesite e planeve tarifore One Business+ Professional dhe Enterprise mund të përdoren në roaming kundrejt tarifës ditore prej 200 leke, ndërsa njesite e planit tarifor One Business+ Exclusive mund të përdoren në roaming falas, pa tarifim shtesë.
- 3) Interneti në roaming do të tarifohet për çdo 10 KB. Pas përfundimit të MB të përfshira në paketë, do të aplikohen tarifat standarde të vlefshme në Roaming.
- 4) Koha fillestare e bisedës për telefonatat hyrëse dhe dalëse në Roaming është 60 sekonda. Pas përfundimit të kohës fillestare gjatë këtij shërbimi do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 5) Për të mësuar më shumë mbi zonat, shtetet, operatorët, paketat dhe tarifat për njësi për shërbimin Roaming klikoni: <http://smartroam.one.al/>
- 6) Në përputhje me dokumentin referencë ndërkombëtar të përhershëm të GSMA, datë 16.12.2014, Versioni 24.6, "Afatet për transferimin e të dhënave data" për marrëveshjet e Roaming ku shoqëria ONE ALBANIA SHA është palë, në raste të vecanta, mund të krijohen vonesa të shkëmbimit të të dhënave roaming deri në 30 ditë midis operatorëve në marrëdhënie roaming me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, në keto raste detyrimi për pajtimtarin për shërbimet roaming të konsumuara në muajin paraardhës mund të pasqyrohen në faturën në vijim në muajin pasardhës.

SHËNIME TË TJERA PËR ZONËN BALLKANI PERENDIMOR:

- 7) Të gjithë Klientët që i përkasin programeve One me kontratë, të rinj dhe ekzistues të cilët do të vizitojnë Shtetet e Ballkanit Perëndimor do të mund të përdorin njësitë e përfshira në programin e tyre (minuta kombëtare, SMS kombëtare, Internet) FALAS sikur të ishin në territorin Shqiptar, duke i zbritur ato nga programi perkates me konceptin Roam Like Home (RLAH).
 - i. ONE ka të drejtë të aplikojë Politikën e Përdorimit të Drejtë të Shërbimit të të Dhënave në Roaming sipas Rregullores



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Lagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

së AKEP, specifikuar më sipër.

ii. Pas konsumit të njësive data internet të lejuara në programin përkatës, ONE do të aplikojë një tarifë shtesë prej 1.14 lekë/MB.

- 8) Telefonata dhe SMS Dalëse Kombëtare quhen të gjitha thirrjet e gjeneruara nga shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe të terminuara në operatorët celularë të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe të Shqipërisë. "Destinacionet e tjera" janë operatorët fiks në Shqipëri & Ballkanin Perëndimor si dhe shtetet e tjera ndërkombëtare dhe do të tarifohen sipas tabelës me sipër.
- 9) Thirrjet hyrëse prej operatorëve celularë të Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë janë FALAS. Të gjitha thirrjet e tjera të terminuara nga shtetet e tjera (operatorët fiks Shqipëri/Ballkani Perëndimor dhe shtetet e tjera ndërkombëtare) do të tarifohen sipas tabelës më sipër.
- 10) Te gjitha SMS hyrëse janë FALAS.
- 11) Tarifimi i minutave dalëse do të kryhet fillimisht për 60 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 12) Tarifimi i minutave hyrëse do të kryhet fillimisht për 30 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 13) Interneti do të tarifohet për çdo 10 KB.
- 14) Shteti i Kosovës, Bosnie Hercegovinës, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do të vazhdojë të jetë te përfshirë tek paketat aktuale të vlefshme në Roaming dhe do të vazhdojnë të ofrohen në treg si një alternative shumë e mirë për klientët me kontratë. (te gjitha rrjetet janë të përfshira në këto paketa). Në këto raste, njësitë të përfshira në program me konceptin RLAH do të kenë prioritet mbi paketat Roaming.

Pajtimtari deklaron se ka lexuar dhe është plotësisht në dijeni të Kushteve të Përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për Pajtimtarin, të cilat janë pasqyruar dhe mund të aksesohen në link-un e mëposhtëm:

<https://www.one.al/kushtet-e-pergjithshme/>

Pajtimtari deklaron se i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej ONE dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.